

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | 'Ripërtëritja' e PD është jetike                                                                                                                                                                                                                                                  |
| ADRESA  | <a href="https://www.syri.net/politike/919186/video-berisha-shqiperia-ngjan-me-nje-te-semure-ne-urgjence-kerkon-nderhyrje-te-menjehershme/">https://www.syri.net/politike/919186/video-berisha-shqiperia-ngjan-me-nje-te-semure-ne-urgjence-kerkon-nderhyrje-te-menjehershme/</a> |
| BURIMI  | syri.net                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 25 shtator 2026, 17:05:28 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 16:45:42 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 3f67eb482c8910710a3059d469fd018c5db76a07ea9536e35d157b43f57e4847 |
| TEKSTI     | 8a23060edbc081ef03d18094fcf2abb5da07e797c357582dced2736c700c4aab |
| PAMJA      | 9b3befe46a0afef05e5fb705e3c29af6f9ef0ddb17eb8b8f3118bab0ef428a1e |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | d2c000948b1449c0e7319a8be6cb8211b165191d83ac2e3ad7534cebbb4ea65d                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d2c000948b1449c0e7319a8be6cb8211b165191d83ac2e3ad7534cebbb4ea65d>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtarëve

**ENVER BYTYÇI**

Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!

**LAJMI I FUNDIT****LIVE/ Foltorja e Ripërtëritjes me Kryetarin e PD-së, Sali Berisha, në Elbasan****më të lexuarat**

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



Mashtrimi me shëndetësinë falas: Shqipëria e dyta në Europë për koston e lartë



Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë




'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë



Akuzat për shefen e SHSH, Ndoja: Kjo është rënia e shtetit, është bashkuar me krimin



Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të Ramës

**VIDEO/ Berisha: Shqipëria ngjan me një të sëmurë në urgjencë, kërkon ndërhyrje të menjëhershme**

18:45, 25/09/2026

**ZMADHO TEKSTIN**

Kryetari i PD-së, Sali Berisha, në 'Foltoren e Ripërtëritjes' në Elbasan, e krahasoi Shqipërinë me një të sëmurë në urgjencë, duke deklaruar se vendi ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme.

'Shqipëria realisht ngjan me një të sëmurë në sallën e urgjencës', tha Berisha, duke e lidhur 'Ripërtëritjen' e PD-së me atë që ai e cilësoi si rithemelimin e Shqipërisë.

**Pjesë nga fjala e kreut të PD, Sali Berisha:**

*Sot, jo vetëm ilaçet, por mbi 600,000 pensionistë janë me pensione të pjesshme. Janë me pensione të pjesshme, janë me pensione me të cilat absolutisht nuk marrin dot as dy javë ushqime, pa le ndihmë nga familjarët e tyre.*

*Sot, këto ditë publikohet lajmi se për të rritur një fëmijë, foshnja në vitin e parë, kërkon 66% të rrogës. Prandaj dhe ne jemi, kemi rënë në këtë mënyrë. Qiratë kanë kapur nivelin e rrogës mesatare. Pra, janë bërë mollë e ndaluar apartamentet për qytetarët.*

*Të gjitha këto faktorë shtojnë qytetarët tanë të ikin, të ikin, të ikin. Ndërkohë, vendi është absolutisht vendi i pasurive përrallore. I pasurive përrallore të gjithanshme. Nuk ka tokë dhe vend më të begatë se Shqipëria në çdo aspekt. Por të gjitha këto janë shndërruar në një mënyrë apo në një tjetër, në mallkim për qytetarin shqiptar.*

*Janë shndërruar në parajsë për qeveritarë të pangopur dhe hajdutë, të cilët në mënyrë identike me ata që shtypën shqiptarët 46 vite, urrejnë qytetarin. Mund të listojmë një listë të pafundme të problemeve të jashtëzakonshme të rënda që përballen qytetari, për shëndetin e tij, për shkollimin e fëmijëve.*

*U ndala në këtë paraqitje për të theksuar se sirenat e nevojës për rithemelimit të Shqipërisë bien në të katër anët e vendit. Shqipëria realisht ngjet me një të*

*semure ne sallën e urgjences.*

*Ngjet me një të sëmure në sallën e urgjencës i cili kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Ndaj dhe ripërtëritja e Partisë Demokratike është jetike dhe përcaktuese për ripërtëritjen e Shqipërisë.*

*Ju, ju them unë ju, keni meritë të jashtëzakonshme, sepse në kushtet më të vështira i qëndruat opozitarë. I qëndruat dhëmbë për dhëmbë këtij regjimi. I qëndruat të pamposhtur pavarësisht nga të gjitha, nga dhuna, terrori, burgosjet, shantazhet, presionet e të tjerë, të gjithë makinerinë e tij.*

*Pa ju, pa qëndresën tuaj, pa guximin tuaj, ky regjim nuk ishte i shpërbërë në të sotmen. Jo. Pra, në këtë kuadër, fitorja jonë është një domosdoshmëri. Jo për t'u kthyer shpinën, jo për t'i injoruar ata qëndrestarë që për mua janë heronj, heronj të vërtetë. Por për të përshkruar kilometrin e fundit drejt fitores.*

*Për të ecur drejt fitores. Për të ecur drejt fitores. Demokratët, populli opozitar pret fitoren. Shqipëria pret me padurim fitoren e opozitës. Dhe kjo është përgjegjësi e madhe ndaj vendit.*

*Ky është motivi i jashtëzakonshëm për ne.*

© SYRI.net

Lexo edhe:



VIDEO/ Berisha: 'Tiranë mediatike' fsheh Shqipërinë e varfër dhe emigracionin, 1.1 milion shqiptarë janë larguar



118 ditë rezistencë popullore – Skandalet e reja, protestuesit kërkojnë dorëheqjen e Ramës dhe qeverisë së tij



'Ngjyra blu, ngjyra e shpresës'/ Alizoti: Rrënja e mirë prodhon risi të mirë! PD ka nevojë për qëndrestarët dhe të rinjtë

Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026

Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

## TË NGJASHME



VIDEO- 'Dyqanet plot, xhepat bosh'/ Berisha: Pensionistët nuk blejnë dot ilaçet, regjimi i Ramës po shkatërron Shqipërinë



'Të mos ketë derë të mbyllur për të rinjtë'/ Narazani: Ripërtëritja e PD ka nisur, Elbasani është dëshmia



VIDEO/ Berisha: Vezë mbi Padrinon në New York! Dënoj me forcë sharjet e Ramës ndaj diasporës



Shqipëria sot me Ramën, më e rrezikuar se në 1913, kur kërkohej copëtimi i saj!



'15 mijë euro nata në hotel'/ Ish-deputetja e PS: Rama harxhon 5 vite pension të një shqiptari në një natë



'Vlora Hyseni në krye të SHISH, jo rastësi', Paloka: Synonte marrëdhëniet Kosovë-Serbi-Shqipëri, favorizohej Vuçiç



S'ndalet mazhoranca/ Qeveria dërgon në Kuvend 'Territorialen', parashikohet shkrirja e 15 bashkive

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTE KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione [info@syri.net](mailto:info@syri.net), për reklama [marketing@syri.net](mailto:marketing@syri.net)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.